



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 15.06.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Nga të dhënat paraprake të administruara nga DPSHTRR, Durrës, rezulton se numri i mjeteve të regjistruara në territorin e qytetit të Durrësit ka pësuar rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Vetëm numri i autoveturave është rritur nga 54,701 mjete në vitin 2021 në 73,484 mjete në janar të vitit 2026, ndërsa edhe automjetet për transport pasagjerësh (ATP) kanë shënuar një rritje të qëndrueshme. Kjo tendencë ka sjellë një presion të shtuar mbi infrastrukturën ekzistuese rrugore dhe mbi kapacitetet aktuale të parkimit, duke e bërë të nevojshme ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e menaxhimit të trafikut dhe organizimin e parkimit në qytet.

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe në përputhje me objektivat e zhvillimit urban të Bashkisë Durrës, janë identifikuar dhe propozuar disa zona me potencial për zhvillimin e parkimeve publike nëntokësore. Këto ndërhyrje synojnë krijimin e një infrastrukture moderne dhe funksionale parkimi, e aftë për të përballuar kërkesën në rritje për hapësira parkimi, duke reduktuar njëkohësisht ngarkesën mbi hapësirat publike ekzistuese dhe duke përmirësuar organizimin e qarkullimit urban.

Pikat e propozuara janë përzgjedhur mbi bazën e analizës së rrjetit rrugor, flukseve të trafikut, aksesit urban, afërsisë me qendrat e shërbimeve dhe lidhjes me sistemin e transportit publik. Kërkesa për zhvillimin e këtyre infrastrukturave mbështetet jo vetëm në rritjen e vazhdueshme të numrit të mjeteve, por edhe në nevojën për të garantuar një zhvillim urban të qëndrueshëm, në përputhje me standardet bashkëkohore të mobilitetit dhe përdorimit racional të hapësirës publike. Nevoja për krijimin e kapaciteteve të reja të parkimit bëhet edhe më e rëndësishme në kushtet kur Bashkia Durrës ka ndërmarrë dhe parashikon të zgjerojë më tej politikat e menaxhimit të parkimit në territorin urban. Në zbatim të vendimeve të Këshillit Bashkiak, parashikohet që në një periudhë afatshkurtër një pjesë e konsiderueshme e akseve kryesore rrugore dhe e hapësirave publike të parkimit të funksionojnë sipas sistemit të parkimit me pagesë. Kjo masë synon rritjen e efikasitetit në përdorimin e hapësirës publike, disiplinimin e parkimit, reduktimin e zënies afatgjatë të vendeve të parkimit dhe

përmirësimin e qarkullimit urban, por njëkohësisht rrit ndjeshëm nevojën për alternativa të organizuara dhe me kapacitete të mjaftueshme parkimi.

Në këtë kuadër, zhvillimi i parkimeve publike nëntokësore përbën një instrument të domosdoshëm për përballimin e kërkesës aktuale dhe të ardhshme për parkim. Krijimi i këtyre strukturave do të mundësojë transferimin gradual të parkimit nga sipërfaqja në hapësira të dedikuara, duke krijuar kushtet e nevojshme për lirin progresiv të hapësirave publike ekzistuese. Si rezultat, Bashkia Durrës do të ketë mundësinë të zbatojë politika të mëtijshme në favor të këmbësorëve dhe rezidentëve, përmes zgjerimit të zonave pedonale, krijimit të hapësirave të gjelbra, përmirësimit të sigurisë rrugore, zhvillimit të infrastrukturës për biçikletat dhe rezervimit të hapësirave të caktuara të parkimit për banorët rezidentë. Këto masa do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së jetës urbane, përmirësimin e aksesueshmërisë dhe krijimin e një qyteti më funksional, më të qëndrueshëm dhe më miqësor për qytetarët. Për rrjedhojë, projekti për zhvillimin e parkimeve publike nëntokësore përfaqëson një investim strategjik për qytetin e Durrësit, i cili adreson nevojat aktuale të mobilitetit urban dhe njëkohësisht krijon bazat e nevojshme për transformimin afatgjatë të hapësirës publike, në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe vizionin e Bashkisë Durrës për të ardhmen e qytetit.